

## **Shoqeria "Besa Agroinvest " Sh p k**

**Shenime per Deklarimet Financiare**  
Per periudhen 1 Janar 2020- 31 Dhjetor 2020  
(*Shumat ne Leke*)

### **1. Te pergjithshme**

Shoqeria "BESA AGRO INVEST" sh p k eshte themeluar si Shoqeri me perjegjesi te kufizuar me date 19/05/2014 dhe eshte rregjistruar ne QKR dt 26/05/2014 me **NIPT L41726002A**.

Objekti i shoqerise perfshin Kultivimin e kulturave te ndryshme bujqesore dhe tregtimin e tyre me shumice dhe pakice. Kultivimin e ullirit, vreshtave, pemave frutore me qellim tregetimin e produkteve dhe nenprodukteve te tyre me shumice dhe pakice. Prodhimin e farerave dhe fidaneve dhe tregtimin e tyre. Ngritjen e industrijeve perpunuese te prodhimeve bujqesore dhe blegtore. Ngritjen dhe zhvillimin e agroturizmit. Nxitjen dhe organizimin e te gjitha aktivitetave qe kane te bejne me prodhimin dhe tregtimin e prodhimit te fermerve etj.

Shoqeria kryen aktivitetin e saj ne ambiente dhe token e marre me qera nga Ministria e Bujqesise me "Kontraten per dhenien me qera te tokes bujqesore ne pronesi te shtetit".

Kapitali themeltar i shoqerise me 31.12.2020 eshte i perbere nga kontributi ne para i ortakeve themelues te kesaj shoqerie ne lekene vleren 390.000.000,00 leke, i ndare ne 2 kuota, me vlere nominale 195.000.000 leke dhe perkatesisht me % si me poshte.

1. FONDACIONI "Albanian Besa Capital" -	perqindja e pjesemarrjes	91.81 %
2. FONDI "BESA"	- perqindja e pjesemarrjes	8.19 %

Adresa e zyres qendrore te shoqerise eshte Durrës Fushe Kruje ARRIMERAS Rruga e Çeleve Fushe, Fushe - Kruje, Arrameras, are+truall 6935 m<sup>2</sup>, nga te cilat truall+ndërtese 1433 m<sup>2</sup>, zona kadastrale nr. 1042, nr. pasurie 328/75, vol 14, fq. 209.

Numri mesatar i punonjesve per vitin 2020 eshte 54 (Pesedhjete e kater).

### **2. Politikat kryesore kontabile**

#### **2.1 Bazat e pergatitjes**

Deklarimet financiare te bashkangjitura jane pergatitur ne baze te rregjistrimeve kontabel te mbajtura per qellime te kontabilitetit te vendit konform Ligjit 9228 date 29 Prill 2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare". Pasqyrat Financiare te fund vitit jane paraqitur ne formatin e paraqitur ne Standartet Kombetare te Kontabilitetit te permiresuara ne fuqi (SKK 2).

Sipas parimeve te kontabilitetit ne Shqiperi deklarimet financiare jane pergatitur mbi bazen e konceptit te te drejtave dhe detyrimeve te konstatuara.

Pergatitja e pasqyrave Financiare ne perputhje me kerkesat e SKK te permiresuara kerkon perdonimin e disa vleresimeve kontabile te rendesishme. Kjo gjithashtu kerkon qe manaxhimi i Shoqerise te jape gjykimin e saj mbi zbatimin e politikave kontabile te saj. Fushat te cilat kerkojne nje shkalle te larte ose komplekse te gjykimit ose ato per te cilat vleresimet apo supozimet jane te rendesishme per hartimin e pasqyrave financiare paraqiten ne shenime.

Shpenzimet qe lidhen me te ardhurat e fituara gjate periudhes raportuese njihen ne te njejten periudhe kontabel si dhe te ardhurat perkatese.

Shpenzimet e kryera gjate nje periudhe raportuese, qe ndryshon nga periudha kur ato i sjellin perfitime njesise ekonomike raportuese, rregjistrohen si shpenzime pikerisht ne periudhen kur merren perfitimet. Mbajta e kontabilitetit, i cili perfshin si regjistrimet kontabel dhe sistemin e tij, mbahen ne menyre te kompjuterizuar, me ane te nje programi te kontabilitetit.

Deklarimet financiare jane shprehur ne Leke, e cila eshte monedha shqiptare.

Nje permblehdje te pjeses me te madhe te politikave kontabel mbi bazen e te cilave jane pergatitur deklarimet financiare jane paraqitur sa me poshte:

## 2.2 Aktivet afatshkurtra

*Mjetet Monetare* perfshijne mijete monetare ne arke dhe banke, llogari rrjedhese, investime ne tregun e parase dhe tregje te tjera shume likuide me kontrata jo me te gjata se tre muaj ne vleren neto.

*Investime* perfshin Letra me vlere te njesive ekonomike brenda grupit (aksione)te paraqitura me kosto e amortizuar minus ndonje zhvleresim te mundshem, riblerjen e aksioneve te emetuara me pare nga vete shoqeria aksionare te paraqitura me shumen e paguar per t'i riblere dhe letra me vlere te njesive te tjera ekonomike dhe investime te tjera financiare te mbajtura per tregtim (aksione, obligacione, zoterime ne fonde investimesh, etj te paraqitura me kosto e amortizuar minus ndonje zhvleresim te mundshem).

*Te drejta te arketueshme* perfshijne kerkesa te arketueshme afatshkurtra (kliente), kerkesat e arketueshme nga njesi te tjera te grupit, kerkesat e arketueshme nga njesi ekonomike mbi te cilat ushtrohet nje ndikim i ndjeshem apo ku ka investime te tjera financiare, kerkesa te arketueshme nga pale te tjera te lidhura (debitore te tjere te tjere) te paraqitura me kosto e amortizuar minus ndonje zhvleresim te mundshem si dhe llogari/kerkesa te arketueshme afatgjata per kapitalin aksionar te autorizuar e te emetuar, por te papaguara.

## 2.3 Inventaret

Inventaret e njesive prodhuese perbehen nga lendet e para dhe materialet per konsum, puna ne proces dhe produktet e perfunduara gati per shitje, mallrat e blera dhe te mbajtura per rishitje me pak ose aspak nevoje per ndryshim, qe jane inventare tipike per njesite tregtare si dhe Aktive Biologjike (Gje e gjalle ne rrije e majmeri) te vleresuara sipas Modeli i Kostos ose Modeli i Vleres se Drejte.

Aktivet afatgjata, te klasifikuara si te mbajtura per shitje, vleresohen me vleren me te ulet midis vleres se tyre kontabel dhe vleres se drejte minus kostot e shitjes. Ato paraqiten me vete ne pasqyren e pozicionit finanziar

Inventaret maten fillimi me kosto.

Kostoja e inventarit perfshin: koston e te gjitha materialeve te lidhura drejtperdrejt me prodhimin si dhe koston e shnderrimit te ketyre materialeve ne produkte perfundimtare. Kostot e drejtperdrejta te materialeve perfshijne, perveç çmimit te blerjes, edhe te gjitha kostot e tjera qe nevojiten per te sjelle inventarin ne gjendjen dhe vendndodhjen ekzistuese.

Pas njohjes, nje njesi ekonomike duhet te mate inventarin me vleren me te ulet midis kostos dhe çmimit te vleresuar te shitjes pakesuar me kostot per tu perfunduar dhe shitur.

Inventaret duhet t'i nensstrohen testit te zhvleresimit ne daten e raportimit. Kerkesa per vleresimin e inventarit me vleren me te ulet mes kostos dhe çmimit te vleresuar te shitjes pakesuar me kostot per t,u perfunduar dhe shitur e detyron njesine ekonomike qe te regjistroje ne kontabilitet humbjet nga zhvleresimi ne momentin kur ky i fundit ndodh. Zvogelimet per te arritur ne çmimin e vleresuar te shitjes pakesuar me kostot per t,u perfunduar dhe shitur mund te ndodhin ne ato raste kur ka nje renie te çmimeve te shitjes ose kur shpenzimet e perfundimit apo shpenzimet direkte te shitjeve jane rritur. Ka dhe raste kur disa produkte demtohen perpara se te shiten ose kur disa te tjere mund te mbahen ne sasira te tilla qe nuk mund te shiten brenda nje periudhe kohe te arsyeshme. Ne raste te tilla, kostoja e inventarit duhet te zvogelohet per te arritur ne çmimin e vleresuar te shitjes pakesuar me kostot per t,u perfunduar dhe shitur. Metoda e vleresimit eshte ajo mesatare.

*Shpenzime te shtyra* paraqesin Shuma te paguara ne avance per shpenzime te periudhave te ardhshme ato vleresohen me kosto e amortizuar minus ndonje zhvleresim te mundshem.

*Te arketueshme nga te ardhurat e konstatuara* paraqesin Shuma te arketueshme ne peridha te ardhshme por te konstatuara (te perllogaritura per periudhen ushtrimore) ato vleresohen me kosto e amortizuar minus ndonje zhvleresim te mundshem.

## Aktivet afatgjata

**2.4 Aktive financiare perfshijne** tituj pronesie ne njesite ekonomike brenda grupit, tituj te huadhenies ne njesite ekonomike brenda grapi, tituj pronesie ne njesite ekonomike ku ka interesa pjesemarrese, tituj te huadhenies ne njesite ekonomike ku ka interesa pjesemarrese, Tituj te tjere te mbajtur si aktive afatgjata letrat me vlera (aksionet, bono te thesarit, obligacione, zoterime ne fonde investimesh, etj) qe nuk ka gjasa te shiten brenda 12 muajve te ardhshem te paraqitura me kosto e amortizuar minus ndonje zhvleresim te mundshem

#### **2.4 Aktivet Afatgjata Materiale**

Ne bilanc AAM perfshijne Toka dhe ndertesa, impiante dhe makineri, te tjera Instalime dhe pajisje qe paraqiten me kosto e amortizuar minus ndonje zhvleresim te mundshem si dhe parapagime per aktive materiale dhe ne proces qe paraqiten me vlera nominale e shumes se parapaguar.

Aktivet Afatgjata Materiale jane vleresuar me koston e blerjes dhe kosto te tjera te drejtperdreja qe lidhen me sjelljen e aktivit ne kushtet e nevojshme per funksionimin e tij.

Metoda per llogaritjen e amortizimit per ndertesat dhe instalimet teknike eshte metoda lineare e cila merr ne konsiderate jeten e dobishme ekonomike, ndersa amortizimi per AAM te tjera llogaritet mbi bazen metodes zbriteze.

**Aktive Biologjike** perfshijne Aktivet biologjike jane kafshe e gjalle ose bime qe paraqiten sipas Modelit te Kostos.

Njohja e aktiveve biologjike behet zakonisht ne momentin e blerjes. Njohja behet gjithashtu kur aktivet biologjike gjenerohen / krijohen nga aktivet ekzistuese. Prodhimi bujquesor, i pandare (pavjelur, pakorrur, palindur, paqethur, etj) nga nje aktiv biologjik, nuk njihet si aktiv me vete. Zakonisht njesia ekonomike ben shpenzime gjate gjithe jetes se dobishme te nje aktivi biologjik. Keto shpenzime kontabilizohen dhe perfshihen si pjese e vleres kontabel te aktiveve biologjike, vetem nese ato i plotesojne kriteret e njohjes si aktiv.

Njesia ekonomike mat me kosto minus çdo amortizim te akumuluar dhe çdo humbje nga zhvleresimi i akumuluar, ato aktive vlera e drejte e te cileve nuk eshte menjehere e percaktueshme, pa kosto apo perpjekje shtese. Njesia ekonomike mat produktet bujquesore te siguruara nga aktivet e saj biologjike me vleren e drejte minus kostot e shitjes ne kohen e vjetjes. Nje matje e tille perben koston e produktit bujquesor ne daten e matjes.

Zhvleresimi i aktiveve biologjike te mbajtura me kosto.

Aktivet biologjike, te mbajtura me modelin e kostos, i nenshtrohen testit per zhvleresim ne çdo date raportimi te pasqyres se pozicionit finanziar. Zvogelimet per te arritur ne vleren neto te rikuperueshme mund te ndodhin ne ato raste kur ka nje renie te çmimeve te shitjes, ose kur shpenzimet e perfundimit apo shpenzimet direkt te shitjeve jane ritur. Ka edhe raste kur disa produkte demtohen perpara se te shiten, ose kur disa te tjera mund te mbahen ne sasira te tilla qe nuk mund te shiten brenda nje periudhe kohe te arsyeshme. Ne raste te tilla, kostoja e tyre duhet te zvogelohet per te arritur ne vleren e tyre neto te rikuperueshme. Shuma e zhvleresimit duhet te percaktohet ze per ze. Ne rastet kur nje vleresim i tille nuk eshte praktik, zhvleresimi duhet te matet per nje grup zerash te ngjashem, ose qe kane lidhje me njeri-tjetrin. Zvogelimi duhet te marre parasysh kostot e perllogaritura per perfundimin dhe shitjen e produkteve, por nuk duhet te perfshije fitimin qe do te krijohet ne fazat e mevonshme te prodhimit. Nje zvogelim, i bere ne nje periudhe kontabel te meparshme, duhet te anulohet ne ato raste kur kushtet, mbi bazen e te cilave eshte bere zvogelimi, nuk ekzistojne me.

Çregjistroi

Aktivet biologjike çregjistrohen atehere kur ato shiten. Njesia ekonomike duhet t'i çregjistroje aktivet biologjike edhe ne ato raste kur ato nuk kane me vlera ekonomike per te ardhmen .

Ndryshimet ne vleren e aktiveve biologjike paraqiten ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

**Aktivet afatgjata jomateriale** (AAJM) jane aktive te identifikuveshme jomonetare pa permajtje fizike, te mbajtura per qellim prodhimin e produkteve ose furnizimin e mallrave ose sherbimeve, per t'uua dhene me qira te treteve ose per qellime administrative ato paraqiten me Kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonje humbje te akumuluar nga zhvleresimi

**Detyrime afatshkurtra perfshijne** Titujt e huamarrjes, Detyrime ndaj institucioneve te kredise, Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit , Deftesa te pagueshme, Te pagueshme ndaj njesive ekonomike brenda grupit, Te pagueshme ndaj njesive ekonomike ku ka interesa pjesemarrese te paraqitura me

kosto e amortizuar minus ndonje zhvleresim te mundshem si dhe arketime ne avance per porosi te paraqitura me Vlera nominale e shumes se arketuar ne avance, Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore/shendetsole, Te pagueshme per detyrimet tatumore te paraqitura me Kosto e amortizuar

**Te pagueshme per shpenzime te konstatuara** perfshijne Detyrimet per shpenzimet e perllogaritura te pagueshme ne periudhen pasardhese dhe paraqiten me kosto te amortizuar.

**Te ardhura te shtyra** perfshijne Shuma ne para (ose aktive te tjera) te marra ne avance, per te cilat ekziston detyrimi i ofrimit te furnizimit me mallra ose sherbime ne periudhen pasardhese. Ketu perfshihen edhe grandet qeveritare ose jo qeveritare dhe paraqiten me kosto te amortizuar.

**Provizione** paraqesin Detyrim aktual per te cilin shuma apo koha e shlyerjes eshte e pasigurte.

Vleresimi i shumes se mundshme te nevojshme per shlyerjen e detyrit behet nga drejtuesit e njesise

**Detyime afatgjata** perfshine Titujt e huamarrjes, Detyime ndaj institucioneve te kredise, Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit , Deftesa te pagueshme, Te pagueshme ndaj njesive ekonomike brenda grupit, Te pagueshme ndaj njesive ekonomike ku ka interesa pjesemarrese te paraqitura me kosto e amortizuar minus ndonje zhvleresim te mundshem si dhe arketime ne avance per porosi te paraqitura me Vleren nominale e shumes se arketuar ne avance, Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore/shendetsole, Te pagueshme per detyrimet tatumore te paraqitura me Kosto e amortizuar, Te kerkueshme per nje afat mbi 12 muaj.

**Te pagueshme per shpenzime te konstatuara**-Detyrimet per shpenzimet e perllogaritura te pagueshme pas 12 muajve pas dates se raportimit

**Te ardhura te shtyra** Shuma ne para (ose aktive te tjera) te marra ne avance, per te cilat ekziston detyrimi i ofrimit te furnizimit me mallra ose sherbime pertej 12 muajve pas dates se raportimit

**Provizione** Vlera aktuale e shumes se pagesave per t'u bere

### **Detyime tatumore te shtyra**

Detyime tatumore te shtyra jane shumat e tatimit mbi fitimin, te pagueshme ne periudha te ardhshme, te cilat krijohen per shkak te differencave te perkozhshme te tatushme

**Kapitali i Nenshkruar** paraqitet me *Vlera kontabel e kapitalit aksionar te emetuar*

**Primi i lidhur me kapitalin Arketimet mbi vleren nominale te aksioneve gjate emetimit te tyre te paraqitura** ne transaksionet me aksionet e veta - diferenca mes kostos dhe çmimit te shitjes; Ne blerjen para afatit te aksioneve te veta - diferenca mes kostos dhe vleres nominale te aksioneve (minus) koston direkte qe lidhet me shitblerjen e aksioneve. Ne rastet e kombinimit te bizneseve te njesive nen te njejtin kontroll - diferenca mes kostos dhe vleres nominale te aktiveve neto te blera

**Rezerva rivleresimi** perfshijne te ardhurat dhe shpenzimet e parealizuara qe ne perputhje me SKK-te nuk regjistrohen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve (per shembull, rezerva nga rivleresimi i aktiveve afatgjata materiale (SKK 5) rezerva qe rrjedhin nga diferenca e kursit te kembimit ne rastin e konsolidimit te njesive te huaja te kontrolluara ne perputhje me SKK 9, etj.

Rezerva te tjera perfshijne Rezerva ligjore, Rezerva statutore

**Fitimi i pashperndare paraqesin** Fitimi/humbja e akumuluar nga periudhat kontabel te meparshme qe as nuk eshte paguar si dividend dhe as nuk eshte perdorur per ndonje qellim tjeter nga njesia ekonomike (per shembull per zmadhimin e kapitalit aksionar ose rezervave)

### **Njohja e te ardhurave**

Te ardhurat jane perfitimet ekonomike bruto, te marra gjate periudhes kontabel, si rezultat i rrjedhes normale te veprimitarise se njesise ekonomike, atehere kur keto perfitime ekonomike çojne ne rritjen e kapitalit.

Te ardhurat njihen atehere kur eshte e mundshme qe njesia ekonomike do te kete perfitime ekonomike ne te ardhmen dhe keto perfitime mund te maten me besueshmeri.

Nje njesi ekonomike duhet te mase te ardhurat me vleren e drejte te arketuar ose te arketueshme. Vlera e drejte e shumes se arketuar apo per t'u arketuar merr parasysh shumen e çfaredo zbritje tregtare, zbritjet per shlyerje te menjehershme dhe zbritjet e bera per sasi (vellim) te blere.

Kur rezultati i nje transaksi qe perfshin ofrimin e nje sherbimi mund te vleresojet ne menyre te besueshme, nje njesi ekonomike do te njohe te ardhurat e lidhura me transaksionin duke iu referuar fazes se perfundimit te transaksi ne fund te periudhes raportuese (nganjeherë referuar si metoda e perqindjes se perfundimit).

## **Shpenzimet**

Shpenzimet jane flukse dalese (pakesimet e perfitimeve ekonomike) gjate periudhes reportuese qe rezultojne ne pakesimin e aktiveve apo rritjen e detyrimeve dhe qe zvogelojne kapitalin e njesise ekonomike, duke perjashtuar ketu ato qe lidhen me shperndarjet te pjesemarresit e kapitalit. Njohja e shpenzimeve rezulton direkt nga njohja dhe matja e aktiveve dhe detyrimeve. Nje njesi ekonomike duhet te njohe shpenzimet ne pasqyren e performances financiare kur lind nje ulje ne perfitimet e ardhshme ekonomike qe lidhet me nje pakesim te nje aktivi ose rritje te nje detyrimi, e cila mund te matet me besueshmeri. Shpenzimet per kerkime e zhvillime per gjithesist Jane ngarjuar ne llogarine e shpenzimeve ne periudhen se ciles i perkasin.

### **Te ardhurat dhe shpenzimet financiare**

Te ardhurat financiare permbledhin te ardhurat nga interesi nga fondet e depozituara ne banka, fitimet nga shitja aktiveve financiare te mbajtura per shitje, si dhe fitimet nga kembimet valutore. Te ardhurat nga interesi njihen si detyrite atehere kur perdoret metoda e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare paraqesin shpenzimet per interesat nga huata, humbjet nga kembimet valutore, si dhe humbjet nga zhvleresimet e aktivave financiare. Gjithe kostot e huamarjeve njihen ne humbje fitime mbi bazen e perdorimit te metodes se interesit efektiv.

### **Tatimi mbi fitimin aktual dhe i shtyre**

Shpenzimi (e ardhura) tatimore permban shpenzimin tatimor aktual (te ardhuren tatimore aktuale) dhe shpenzimin tatimor te shtyre (te ardhuren tatimore te shtyre). Shpenzimet qe lidhen me tatimin mbi te ardhurat paraqitet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve pervec rasteve kur ai lidhet me zerat e kapitalit dhe ne kete rast paraqitet direkt ne kapital.

Shpenzimi tatimor aktual eshte shuma e tatimit qe pritet te paguhet bazuar ne te ardhurat e viti ushtrimor, shkallen tatimore qe zbatohet ne diten e raportimit si dhe cdo korrigjim te detyrimeve tatimore te viteve paraardhese. Tatimi i shtyre njihet duke perdorur metoden e pasivit te bilancit, duke marre si diferenca te per Kohshme diferenca midis bazes tatimore te nje aktivi ose pasivi dhe vleres se tij kontabel neto ne bilanc. Tatimi i shtyre llogaritet duke u bazuar ne shkallen tatimore, te percaktuar nga ligjet qe jane ne fuqi, qe pritet te jete e zbatueshme ne momentin kur diferenca e per Kohshme do te zhduket.

Kompania njeh aktivin per tatim te shtyre vetem per aq sa eshte e mundur qe fitimet e tatushme te ardhshme jene te disponueshme kundrejt te cilave te mund te perdoret aktivi tatimor i shtyre. Vlera kontabel e nje aktivi tatimor te shtyre duhet te rishikohet ne cdo date te bilancit. Nje njesi ekonomike do te zvogeloje vleren kontabel te nje aktivi tatimor te shtyre per aq sa nuk ka me mundesi qe fitim i tatushem i mjaftueshem te jete i disponueshem pet te lejuar perfitimin e perdorimit te nje pjese ose i te gjithe atij aktivi tatimor te shtyre. Cdo zvogelim i tille do te rimerret deri ne masen qe behet i mundur disponimi i fitimit te tatushem te mjaftueshem.

### **Transaksionet me monedhat e huaja**

#### *(a) Monedha e perdorur dhe reportuese*

Zerat e perfshire ne pasqyren financiare te seciles prej njesive ekonomike te grupit maten ne monedhen baze te mjedisit ekonomik ne te cilen njesia ekonomike vepron (monedha ne perdorim). Pasqyrat e konsoliduara financiare raportohen ne LEKE shqiptar (ALL), e cila eshte monedha e perdorur dhe reportuese e Kompanise.

#### *(b) Transaksionet dhe Gjendjet*

Transaksionet ne monedha te huaja konvertohen ne monedhen e perdorur duke perdorur kurset e kembimit ne daten e kryerjes se transaksionit. Fitimet dhe humbjet qe rezultojne nga kryerja e transaksioneve ne monedhe te huaj dhe nga konvertimi i aktiveve monetare dhe detyrimeve ne monedhe te huaj me kursin e kembimit te fund-vitit njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e kembimit me te rendesishme jane :

	<b>31 Dhjetor 2020</b>	<b>31 Dhjetor 2019</b>
1 EUR	123.70	121.77
1 USD	100.84	108.64

**3. Aktivet monetare** perfaqesojne gjendjet banke dhe vlerat ne arke. Per llogarite ne valute eshte bere azhornimi me kursin e dates 31.12.2020. Me 31.12.2020 ato detajohen si me poshte:

Aktivet monetare	<b>31 Dhjetor 2020</b>	<b>31 Dhjetor 2019</b>
Para ne dore	121,211	164,213
Para ne Banka	2,534,264	3,732,258
<b>Totali</b>	<b>2,655,475</b>	<b>3,896,471</b>

**4. Te drejta te arketueshme** me 31.12.2020 detajohen si me poshte:

	<b>31 Dhjetor 2020</b>	<b>31 Dhjetor 2019</b>
Nga aktiviteti i shfrytëzimit	878,934	1,337,728
Të tjera	182,870	9,378,036
<b>Totali</b>	<b>1,061,804</b>	<b>10,715,764</b>

#### **4.a. Te Arketueshme per aktivitetin e shfrytezimit**

**Të drejta të arkëtueshme per aktivitetin e shfrytezimit**

	<b>31 Dhjetor 2020</b>	<b>31 Dhjetor 2019</b>
Sejgja shpk	60,104	60,104
Kamila Fruit shpk	18,818	18,818
Kujtim Lika	170,330	933,155
KOSOVA	-	-
IMPULS SHPK	-	-
FRAENO AGRICULTURE EXPORT	-	-
Danish Green Garde Sh.p.k	-	3
Sigal	-	-
Shitje me kase	-	-
Kliente te ndryshem	629,682	325,645
<b>Totali</b>	<b>878,934</b>	<b>1,337,725</b>

#### **5.Inventaret** me 31.12.2020 detajohen si me poshte:

	<b>31 Dhjetor 2020</b>	<b>31 Dhjetor 2019</b>
Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme	1,837,673	5,122,072
Pjese nderrimi	2,913,551	835,676
Aktive Biologjike	10,384	148,287
Mallra	211,350	-
<b>Totali</b>	<b>4,972,958</b>	<b>6,106,035</b>

**5.a Lende e pare dhe materiale te konsumueshme** perfaqesojne lende te para per prodhim bujqesor dhe inventar te imet te detajuara si me poshte:

	<b>31 Dhjetor 2020</b>	<b>31 Dhjetor 2019</b>
Lende e pare	1,812,363	3,522,669
Inventar i imet	25,310	1,599,403
<b>Totali</b>	<b>1,837,673</b>	<b>5,122,072</b>

**5.b Aktivet biologjike** afatshkurter perfaqesojne gjendjen e produktit bujqesor te pavjele, por qe pritet te vilet ne nje periudhe me pak se nje vit dhe paraqitet i detauar si me poshte:

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Patate	776	-
Materiale te para	9,608	-
Jonxhe	-	148,288
	<b>10,384</b>	<b>148,288</b>

**6. Shpenzime te shtyra me 31.12.2020 Detajohen si me poshte:**

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Qera Toka (Min Bujqesise )	2,245,198	2,245,198
Paradhenie per ndertim SERA 3	-	7,000,000
Paradhenie per ndertim SERA 2	-	68,000
Mirembajtje Alpha	-	-
Shpenzime te periudhave te ardhshme per kulturat bujqesore	332,099	1,543,840
Shpenzime te periudhave te ardhshme domate	84,000	-
Shpenzime te periudhave te ardhshme spec	50,163	-
Shpenzime te periudha te ardhshme Dardha	2,840	-
Shpenzime te periudha te ardhshme Kumbull	10,938	-
Sigurimi i Hyundai AA 164 NT	-	34,464
Sigurimi i Albsig per deshmi garancie per sigurim kontrate me AZHBR	-	31,667
Sigurimi i mjeteve per 2020	63,460	-
Sigurimi i Citroenit AA036ZY	3,050	-
Shpenzime te periudhave te ardhshme administrative	27,632	-
Shpenzime te periudh.ardh.Grure	289,588	-
Shpenzime te periudh.ardh.Qepe e njome	26,240	-
Shpenzime te periudh.ardh.Patellxhan	90,174	-
Shpenzime te periudh.ardh.Sallate	80,960	-
Shpenzime te periudh.ardh.Laker	151,909	-
Shpenzime te periudha te ardhshme inspekimi global gap	-	68,139
Te tjera	-	61,108
	<b>3,458,251</b>	<b>11,052,415</b>

**7. Aktive afatgjata *materiale* me shtesat, pakesimet si edhe amortizimin perkates te njojur per vitin 2020 paraqiten te detajuara si me poshte:**

	Te tjera makineri e pajisje	Makineri paisje Mjete transporti	Pajisje informative	Mobilie dhe paisje zyre	Te tjera ne shfrytezim	Totali
<i>Aktive te Trupezuara</i>	-	-	-	-	-	-
<b>Gjendje 01.01.2020</b>	<b>178,179,312</b>	<b>18,693,239</b>	<b>1,478,926</b>	<b>2,163,855</b>	<b>24,684,194</b>	<b>225,199,526</b>
Shtesa	7,569,952	1,153,060	83,863	691,593	-	9,498,468
Pakesime	163,380	-	-	-	-	163,380
<b>Gjendje 31.12.2020</b>	<b>185,585,884</b>	<b>19,846,299</b>	<b>1,562,789</b>	<b>2,855,448</b>	<b>24,684,194</b>	<b>234,534,614</b>
<i>Amortizimi</i>	-	-	-	-	-	0
<b>Gjendje ne 01.01.2020</b>	<b>16,908,719</b>	<b>2,846,052</b>	<b>431,650</b>	<b>439,795</b>	<b>2,495,595</b>	<b>23,121,811</b>
Shtesa llogaritur	3,611,988	-	-	400,000	-	4,011,988
Pakesime	0	-	-	-	-	0
<b>Me 31.12.2020</b>	<b>20,520,707</b>	<b>2,846,052</b>	<b>431,650</b>	<b>839,795</b>	<b>2,495,595</b>	<b>27,133,799</b>
<i>Vlera neto 01.01.2020</i>	<i>161,270,593</i>	<i>15,847,187</i>	<i>1,047,276</i>	<i>1,724,060</i>	<i>22,188,599</i>	<i>202,077,715</i>
<i>Vlera neto 31.12.2020</i>	<i>165,065,177</i>	<i>17,000,247</i>	<i>1,131,139</i>	<i>2,015,653</i>	<i>22,188,599</i>	<i>207,400,815</i>

Inventari i aktiveve afatgjate materiale eshte vleresuar me koston e marjes se tyre. Vlerat e mesiperme te AQT, perputhen me inventarin fizik te tyre date 31.12.2020, jane prone e shoqerise, si dhe jane dokumentuar ne menyre te rregullt.

**8. Aktivet biologjike afatgjata me 31.12.2020 detajohen si me poshte:**

	<b>31 Dhjetor 2020</b>	<b>31 Dhjetor 2019</b>
Kajsi	10,154,022	10,154,022
Pjeshka	6,871,478	6,871,478
Nektarina	32,442,795	32,442,795
Dardha	10,696,867	10,696,867
Kumbull	6,601,866	6,601,866
Shega	398,974	398,974
<b>Totali</b>	<b>67,166,002</b>	<b>67,166,002</b>

Aktivet biologjike te shoqerise jane kryesisht produkte bujqesore, te cilat jane klasifikuar si aktive biologjike afatshkurtra si dhe drure frutore, te cilet jane klasifikuar si aktive biologjike afatgjata.

**9. Aktive tatumore te shtyra me 31.12.2020** ne vleren 9,700,714 jane llogaritur per efektin e humbjes qe do te mbartet per llogaritjen e tatum fitimit te vitiit te ardhshem.

**10. Detyrime afatshkurtra me 31.12.2020 detajohen si me poshte:**

	<b>31 Dhjetor 2020</b>	<b>31 Dhjetor 2019</b>
Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	1,241,126	3,319,380
Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetsore	579,749	574,901
Të pagueshme për detyrimet tatumore	955,914	1,118,660
Te tjera te pagueshme	160,226	-
	<b>2,937,015</b>	<b>5,012,941</b>

**10.a Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit perfaqesojne detyrimet ndaj furnitoreve me 31.12.2020**

	<b>31 Dhjetor 2020</b>	<b>31 Dhjetor 2019</b>
Agripro	-	413,280
MAJLINDA DEMOLLARI	-	18,500
Agroimput Jazxhi	-	14,000
Anastas Qorri	-	119,982
ARLI INTERNACIONAL	-	1,030
Bruka Seedling shpk	-	48,000
Bukurije Daja	-	28,000
EURO GROUP shpk	119,652	119,652
Focus Press	-	22,500
HYUNDAI AUTO ALBENIA	-	98,882
Lisar Seedling	600,000	-
Ramazan Cani	-	176,499
SIGAL UNIKA GROUP AUSTRIA	-	4,919
M.B.M	-	33,500
S&I Sh.p.k	43,947	-
Miftar Babasi	184,000	-
Lila	-	-
Agrimatco	-	444,600
Namik Ramaj	-	26,800
te tjere	-	95,222
Pashk Musteqja	22,000	1,700
Lila Sh.p.k	85,000	443,280
Sigma Vig Sh.a	3,012	3,012
Arben Karamuca	-	6,594
Megatek	-	1,728

Zamir Stojku	12,797	12,797
Alushi Trans Sh.p.k	-	137,814
Ajim Kurti	-	4,260
Alfred Elezi	-	300
Edlir Garipi	-	326,056
Dhimiter Vasi	-	9,500
Alfresh Production Sh.p.k	-	137,000
Karaj 1 Konstrukcion	-	225,000
Te tjere	170,718	344,973
	<b>1,241,126</b>	<b>3,319,380</b>

**10.b** Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore/shendetore detajohen si me poshte:

	<b>31 Dhjetor 2020</b>	<b>31 Dhjetor 2019</b>
Paga per tu paguar		
Sigurime per tu paguar	517,262	574,901
<i>Tatim mbi pagat</i>	<u>62,487</u>	<u>70,984</u>
	<b>579,749</b>	<b>645,885</b>

Gjate vitit 2020 jane llogaritur dhe shlyer detyrimet per sigurimet shoqerore dhe ato shendetesore te cilat jane kalkuluar, bazuar ne legjislacionin ne fuqi.

**10.c** Te pagueshme per detyrimet tatimore me 31.12.2020 detajohen si me poshte:

	<b>31 Dhjetor 2020</b>	<b>31 Dhjetor 2019</b>
Tatim mbi pagat	-	-
TVSH	8,265	-
Tatim ne burim	(5,877)	17,676
Taksa vendore	<u>953,526</u>	<u>1,030,000</u>
	<b>955,914</b>	<b>1,047,676</b>

**10.d** Te tjera te pagueshme perfaqesojne detyrimet ndaj personave te trete per sherbime te kryera kundrejt mbajtjes se tatimit ne burim te cilat edhe per vitin 2020 jane furnizime per te cilat pritet te sillen faturat perkatese me qellim likuidimin e tyre.

	<b>31 Dhjetor 2020</b>	<b>31 Dhjetor 2019</b>
Furnitore per fatura te pamberritura	160,226	-
	<b>160,226</b>	<b>-</b>

**11. Detyrimet afatgjata te kompanise** me 31.12.2020 ne vleren 56'186'488 Leke paraqesin kredite e marra nga Fondi Besa gjate vitit 2018 per ndertimin e serave dhe realizimin e investimeve ne makineri bujqesore. Kjo kredi u mundesa nga projekti PMU ne bashkepunim me Fondin Besa Sh.a dhe Ministrine e Financave.

	<b>31 Dhjetor 2020</b>	<b>31 Dhjetor 2019</b>
Kredi Fondi Besa	56,186,488	69,410,564
	<b>56,186,488</b>	<b>69,410,564</b>

**12. Kapitali** me 31.12.2020 paraqitet i detauar sipas zerave:

	<b>31 Dhjetor 2020</b>	<b>31 Dhjetor 2019</b>	<b>Diferencia</b>
Kapitali aksionar	390,000,000	355,000,000	35,000,000
Rezervat ligjore			-
Rezerva nga rivleresimi	29,846,773	29,846,773	-
Fitimet e pasperndara	(148,164,022)	(103,488,940)	(44,675,082)
Fitimi (Humbja) e vitit finanziar	(34,390,236)	(44,675,082)	10,284,845
<b>Totali</b>	<b>237,292,515</b>	<b>236,682,752</b>	<b>609,763</b>

### 13. Shitjet neto

	Viti 2020	Viti 2019	Diferencia
Shitje produktesh	16,862,181	13,184,016	3,678,165
	<b>16,862,181</b>	<b>13,184,016</b>	<b>3,678,165</b>

### 14. Te ardhura te tjera te shfrytezimit

	Viti 2020	Viti 2019	Diferencia
Sigal	1,917,095	-	1,917,095
	<b>1,917,095</b>	<b>-</b>	<b>1,917,095</b>

Totali i shitjeve eshte 16'862'181 Leke + 1'917'095 Leke eshte 18'779'276 Leke ndersa ne FDP shuma eshte 18'761'746 Leke. Diferencia prej -82'470 Leke vjen si rezultat i credit note-ve te leshuara nga nje klient ne Serbi, per te eshte leshuar fature me zbritje nga ana jone. Mirepo ne plotesimin e FDP-ve perkatese nuk pranohej nga formati ne e-filing i TVSH vlera me minus ne seksionin e shitjeve te perjashtuara/me tvsh 0%, totali i se cilave eshte -82'470 Leke, pikerisht sa differenza si me lart.

### 15. Ndryshimi ne inventarin e produkteve te gatshme dhe prodhimit ne proces perfaqeson kosto produkteve buqesore te shitura:

	Viti 2020	Viti 2019	Diferencia
Ndryshimi ne inventarin e produkteve te gatshme dhe prodh proc	(8,745,359)	(12,964,823)	4,219,464
	<b>(8,745,359)</b>	<b>(12,964,823)</b>	<b>4,219,464</b>

### 16. Te Puna e kryer nga njesia ekonomike dhe e kapitalizuar per vitin 2020 perfaqeson punen e kryer per aktivet biologjike afatgjata te cilat jene peme frutore, dhe aktivet afatshkurter.

	Viti 2020	Viti 2019	Diferencia
Kapitalizimi I sherbimeve per Akt.			
Biologjike afatgjata	8,607,455	9,333,723	(726,268)
Aktiv biologjik afatshkurter ne proces	-	13,098,839	(13,098,839)
	<b>8,607,455</b>	<b>22,432,562</b>	<b>(13,825,107)</b>

### 17. Lenda e pare dhe te tjera shpenzime te pa stokueshme. Per vitin 2020 ato detajohen si me poshte:

	Viti 2020	Viti 2019	Diferencia
Lende te para dhe materiale	12,301,465	11,091,031	1,210,433
Karburant	42,729	4,131,524	(4,088,795)
Energji uje	698,620	1,605,596	(906,976)
Totali	<b>13,042,814</b>	<b>16,828,152</b>	<b>(3,785,338)</b>

### 18. Shpenzime te personelit

Ne kete ze perfshihen shpenzimet e pages dhe sigurimet shoqerore si me poshte:

	Viti 2020	Viti 2019	Diferencia
Shpenzime paga	23,660,216	29,564,855	(5,904,639)
Shpenzime per sigurimet shoq	3,897,437	4,921,202	(1,023,765)
Sigurime te paguara nga kompania per punonjes te larguar	-	6,264	(6,264)
	<b>27,557,653</b>	<b>34,492,321</b>	<b>(6,934,668)</b>

### 19.Zhvleresimi i aktiveve financiare dhe investimeve financiare te mbajtura si aktive afatshkurtra.

Per vitin 2020 ashtu sikurse edhe ne vitin 2019 nuk ka zhvleresim te aktiveve financiare dhe investimeve financiare si aktive afatshkurtra.

### 20. Shpenzime te tjera shfrytezimi jane sherbime te ndryshme te detajuara si me poshte:

	Viti 2020	Viti 2019	Diferencia
Qera	2,056,798	3,635,798	(1,579,000)
Mirembajtje	1,787,487	1,238,607	548,880
Siguracione	173,211	428,271	(255,060)
Sherbime te ndyshme	4,033,448	2,238,685	1,794,764
udhetime djeta	147,426	384,397	(236,971)

Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	196,031	243,425	(47,394)
Transport	1,320	35,368	(34,048)
Sherbime bankare	12,180	572,012	(559,832)
Taksa vendore	798,878	2,711,594	(1,912,716)
Taksa te tejra	3,600	212,118	(208,518)
Pritje percjellje	-	10,750	(10,750)
Gjoba	126,155	363,687	(237,532)
Humbje nga gabime te lejuara ne ushtrimet	36	170	(134)
Shpenzime nga forcat madhore - permbytje, zjarr, termet, etj.	-	154,123	(154,123)
Shkulje e mandarinave ne sip. 1 ha	-	345,858	(345,858)
Humbje nga kembimet valutore	26,730	-	26,730
<b>Totali</b>	<b>9,363,301</b>	<b>12,574,863</b>	<b>(3,211,561)</b>

## 21. Te Ardhurat dhe Shpenzimet Financiare

Ne kete ze perfshihen interesat pozitive (negative), si dhe diferenca e konvertimit aktive dhe pasive te detajuar si me poshte :

	Viti 2020	Viti 2019	Diferencia
Fitim nga kursi kembimit		1,377,154	(1,377,154)
te ardhura nga interesat		166,279	(166,279)
Humbje nga kursi		(16,679)	16,679
Te ardhura nga dhurime	596,064		
Shpenzime interesa	(1,217,533)	(1,171,094)	(46,439)
te ardhura te tjera financiare	1,565,616	252,088	1,313,528
	<b>944,147</b>	<b>607,749</b>	<b>(259,665)</b>

**22. Tatim fitimit te shtyre** eshte llogaritur per te paraqitur te drejten e kompanis per te ulur shpenzimet per tatimin mbi fitimin ne vitet e ardhshme. Kjo si pasoje e humbjes ne vite.

Per te llogaritur tatim fitimin e shtyre jane marre parasysh efektet e shpenzimeve te panjohura per efekt te llogaritjes se tatimit mbi fitimin sipas legjislacionit tatimor ne fuqi.

Gjithashtu vleresohet se te ardhurat vitit te ardhshem do ta mbulojne humbjen e dy viteve te para.

	Viti 2020	Viti 2019	Diferencia
<b>Fitimi (humbja) i/e viteve para tatimit</b>	<b>(34,390,236)</b>	<b>(44,675,082)</b>	<b>10,284,845</b>
Shpenzimet e pazbritshme per efekt fiskal	126,155	363,687	(237,532)
<b>Rezultati tatimor</b>	<b>(34,264,081)</b>	<b>(44,311,394)</b>	<b>10,047,313</b>
<i>tatim fitimi 15%</i>			
<i>Shpenzimi i tatim fitimit te shtyre</i>	<i>-</i>	<i>-</i>	<i>-</i>
 Fitimi neto	 <b>(34,390,236)</b>	 <b>(44,675,082)</b>	 <b>10,284,845</b>

**23. Fitimi neto** i shoqerise pas tatimeve per vitin 2020 llogaritet si me poshte:

	Viti 2020	Viti 2019	Diferencia
<b>Fitimi (humbja) i/e viteve para tatimit</b>	<b>(34,390,236)</b>	<b>(44,675,082)</b>	<b>10,284,845</b>
Shpenzimet e pazbritshme per efekt fiskal	126,155	363,687	(237,532)
<b>Rezultati tatimor</b>	<b>(34,264,081)</b>	<b>(44,311,394)</b>	<b>10,047,313</b>
<i>tatim fitimi 15%</i>			
<i>Shpenzimi i tatim fitimit te shtyre</i>	<i>-</i>	<i>-</i>	<i>-</i>
 Fitimi neto	 <b>(34,390,236)</b>	 <b>(44,675,082)</b>	 <b>10,284,845</b>

Administratori

Estref ÇEKREZI



Financieri

Orges DEDA